



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 28/10/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23/10/2020 të parashtruar nga *Grupi O.E Parajsa SHPK& NNSH Emsa” Lipjan*, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica** me nr te prokurimit 613-20-2177-521 nxjerr këtë ;

VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pabaze, e parashtruar nga *Grupi O.E Parajsa SHPK& NNSH Emsa” Lipjan* pjesëmarrës në tenderin me titull: **Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica** me nr te prokurimit 613-20-2177-521

Vërtetohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 20/10/2020;

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupi O.E Parajsa SHPK& NNSH Emsa” Lipjan pjesëmarrës **Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica** me nr te prokurimit 613-20-2177-521, me datë 23/10/2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartëpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 27/10/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe gjatë vlerësimit AK ka zbatuar me përpikëri dispozitat nga LPP dhe rregullat e nxjerra nga KRPP

Siç jeni njoftuar edhe me letren standarde Ju keni ofruar dy katalogje për këto pajisje dhe kjo për autoritetin kontraktues është e papranueshme sepse në nenin 4.1 të FTD është përcaktuar se nuk lejohen variantet . Në arsyetimin se gabimisht e keni futur dy katalogje nuk qëndron sepse në të dyja është titulli i tenderit për të cilin keni aplikuar , kjo është vërtetuar edhe nga OSHP me Vendimin 669/20 të datës 15/10/2020 e vërteton se ju keni ofruar dy katalogje.

Sa i përket ankeses tuaj se grupi i operatorve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk janë të përgjegjshëm se nuk i ka dy komimino me kapacitret mbi 10 m³ nuk qëndron sepse në listë i kanë 3 kamion me kapacitet mbi 10m³ ndërsa këtë e dëshmon edhe me libreza e këta kamion janë me targa :01-480-MC; 01-419 AI, e të tjerët që janë të me kapacitet me te vogël nuk po i përmend sepse vetë 2 kamion janë kërkuar me kapacitet prej 10m³.

Sa i përket regjistrimit për lugë ngarkuese pasi që është dorëzuar kontrolla teknike dhe sigurimi kjo është plotësiht valide sepse me krijimin e kushteve është mundësuar regjistrimi I kësaj pajisje .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Adem Duriqi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

